REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 44632/26
Nr. i fq. / Br. st. -2-
Data: / Datum 29.09.2026
VUSH

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 138/25 29/09/2026

Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, pika "d" në lidhje me nenin 24, paragrafi 2, nenit 40, paragrafi 2, pika "b" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 20 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, nenit 19.2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 në lidhje me nenin 18 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **24 shtator 2026,** merr këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2027 SI DHE PROJEKSIONET PËR VITIN 2028-2029

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027 si dhe projeksionet për vitet 2028-2029, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2027 dhe 02/2027, të lëshuara nga Ministria e Financave.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027 është: **31,683,485.00 €** prej të cilave për:

Kategoritë Buxhetore	2027	2028	2029
Paga	16,189,307.00	16,270,254.00	16,351,605.00
Mallra dhe shërbime	6,053,280.00	7,149,260.00	7,361,511.00
Komunali	670,012.00	695,000.00	695,000.00
Subvencione	1,480,000.00	2,420,000.00	2,420,000.00
Shpenzime kapitale	5,561,142.00	6,681,641.00	8,173,740.00
Rezerva	1,729,744.00		
TOTALI	31,683,485.00	33,216,155.00	35,001,856.00

3. Ky buxhet financohet nga grantet qeveritare në vlerë prej **27,731,331.00 €** dhe nga të hyrat vetanake në vlerë prej **3,952,154.00 €.**

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me kufijtë buxhetor të dhënë në Qarkoret Buxhetore 01/2027 dhe 02/2027 të lëshuara nga MF-ja.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela: 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2027-2029; tabela 4.2 – financimi i investimeve kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2027-2029; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2027-2029n si dhe tabela e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga kuvendi i komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave, për zbatim.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 4636/26
Nr. i fq. / Br. st. -1-
Data: / Datum 29. 09. 2026
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 139/25 29/09/2026

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) nenin 6 paragrafi. 6 dhe nenin 7 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal Nr. 04/L-010 (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr. 7/10 Gusht 2011), nenit 6 të Rregullores së MAPL për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **24 shtator 2026,** merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E KËRKESËS -NISMËS SË BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për bashkëpunim ndërkomunal ndërkombëtar në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Serdivan Turqi.

2. Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që pas konsultimeve me Kryetarin e Komunës Serdivan, përkatësisht autoritetet komunale kompetente - të përgatis Draft Marrëveshjen e Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërkomunal në fusha të caktuara me interes për të dy komunat.

3. Draft marrëveshja e hartuar në tekstin final, i dërgohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nënshkruhet nga kryetarët e të dy komunave.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 44643/26
-1-
Nr. i fq. / Br. st.
Data: / Datum: 29.09.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 141/26 29/09/2026

Bazuar në nenin 12 par. 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040/2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008), nenit 7 të Ligjit për Policinë Nr. 04/L-076 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 04/19 mars 2012) nenit 3 par. 2 dhe nenin 4 par. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **24 shtator 2026 merr** këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIM TË VENDIMIT LIDHUR ME THEMELIMIN E KËSHILLIT PËR SIGURI NË BASHKËSI

1. Me këtë vendim plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 22294/26 datë 01.06.2026 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim: në pikën 1 pas nënpikës 1.22 shtohet nënpika 1.23 në të cilën z. Blerim Ibrahimi përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi "Qendra" në Vushtrri caktohet anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

2. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen Zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit